



- SALSTAT -



Prill - Gusht 2021

Projekti "Strong Albanian Local Statistics" (Statistika të Forta Vendore Shqiptare, SALSTAT) është pjesë e projektit ombrellë "Bashki të Forta", financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për një periudhë katërvjeçare. Projekti "Bashki të Forta" punon për zhvillimin dhe decentralizimin e qeverisjes vendore në Shqipëri.

Tri palët kyçe të interesit në këtë projekt janë INSTAT-i, bashkitë, si dhe disa ministri të linjës dhe agjenci qeveritare, veçanërisht ato që kanë për detyrë mbledhjen e të dhënave statistikore zyrtare dhe/ose janë përgjegjëse për të dhënat/regjistrat administrativë.

INSTAT-i është partneri kyç i projektit SALSTAT. Ministrinë e linjës dhe bashkitë janë partnere thelbësore pasi ato do të jenë, si përdorueset, ashtu edhe prodhueset e të dhënave për statistikat vendore dhe rajonale.

Përmbajtja:

- Punë përgatitore për Vjetarin Statistikor Rajonal 2021
- Trajnim rreth Statistikave të Menaxhimit të Mbetjeve Shtëpiake
- Trajnim për stafin e ri të INSTAT-it
- Regjistri Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave
- Përmirësimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit dhe infrastrukturave të tjera në Zyrat Rajonale të INSTAT-it
- Trajnime shtesë për bashkitë

Punë përgatitore për Vjetarin Statistikor Rajonal 2021

Departamentet përkatëse vijuan punën për Vjetarin Statistikor Rajonal 2021.

Workshop-i "Udhëzime për Vjetarin e Qarqeve dhe Bashkive 2021" rreth planifikimit dhe përgatitjes së hapave të mëtejshëm për Vjetarin Rajonal 2021 u zhvillua më 29 qershor 2021, dhe u ndoq nga përfaqësuesit e të gjitha departamenteve përgjegjëse të INSTAT-it dhe ekspertit zviceran.

Diskutimet gjatë workshop-it u përqendruan në përmbajtjen e botimit, si dhe bashkërendimin e mëtejshëm të shpërndarjes së udhëzimeve për tregues specifikë.

Puna për Vjetarin Rajonal do të vijojë në muajt e ardhshëm dhe shpërndarja është programuar të zhvillohet më 15 dhjetor 2021.

Trajnim rreth Statistikave të Menaxhimit të Mbetjeve Shtëpiake

Në kuadër të Produktit "Sistemi i mbledhjes së të dhënave përshtatet për të prodhuar të dhënat përkatëse në nivelin rajonal dhe vendor", SALSTAT/INSTAT-i, në sinergji me projektin "Bashki të Forta" (HELVETAS), përfundoi në maj 2021 trajnimin rreth platformës në web për mbledhjen e të dhënave mbi Statistikat e Menaxhimit të Mbetjeve Shtëpiake 2020 me stafin e bashkive.

Pikat kryesore të rendit të ditës ishin:


- Baza ligjore dhe parimet e konfidencialitetit statistikor (INSTAT)
- Statistikat për mbetjet urbane në bashki (INSTAT)
- Aplikimi i mbledhjes së të dhënave (INSTAT)
- Metodologjia për prodhimin dhe mbledhjen e të dhënave rreth informacioneve shtesë (Helvetas)

Për shkak të situatës së pandemisë, trajnimet u organizuan në mjediset e INSTAT-it, me grupe të vogla me përfaqësues të çdo bashkie.

Në trajnim morën pjesë 47 bashki nga 61 në total, që përkthehet në 77% të bashkive. U trajnuan gjithsej 64 punonjës, prej të cilëve 29 ishin femra ose 45% e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve.

Gjatë periudhës 28 korrik - 10 gusht, INSTAT-i dhe SALSTAT-i vendosën të ofronin mbështetje individuale përmes një dite shtesë trajnimi për ato bashki, që nuk e kishin ndjekur trajnimin dhe po hasnin vështirësi me plotësimin e pyetësorit online.

61 bashki përfunduan anketën për Menaxhimin e Mbetjeve Shtëpiake në mesin e gushtit. Të dhënat kombëtare do të shpërndahen më 21 shtator 2021.



Trajnim për stafin e ri të INSTAT-it

Programi i trajnimit për punonjësit e rinj është pjesë e Programit të INSTAT-it për Trajnim dhe Zhvillim. Ky program synon të mbështesë punonjësit e rinj dhe të rrisë kapacitetet statistikore dhe kuptueshmërinë e proceseve dhe strukturave të INSTAT-it.

Trajnimi u zhvillua në mjediset e INSTAT-it nga data 24 deri në datën 28 maj 2021. Temat kryesore që u diskutuan gjatë seancave të trajnimit ishin:

- Prezantim i INSTAT-it dhe Sistemit Statistikor Kombëtar
- Prezantim teknik i Drejtorive të Teknologjisë së Informacionit dhe Gjeoinformacionit
- Prezantim teknik i Drejtorisë së Statistikave Ekonomike dhe Integritetit Evropian
- Prezantim teknik i Drejtorive të Prodhimit Statistikor

Janë trajnuar 20 punonjës, 15 prej të cilëve punojnë në zyrën kryesore të INSTAT-it dhe 5 në zyrat statistikore rajonale në Vlorë, Durrës, Mallakastër, Lushnjë, dhe Kukës. Nga këta 20 punonjës, 13 ishin femra ose me fjalë të tjera, 65% e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve.



Regjistri Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave

Drafti i parë i dokumentit konceptual për Regjistrin Statistikor Shqiptar të Ndërtesave dhe Banesave (RSSHNB) është paraqitur pranë INSTAT-it për t'u diskutuar dhe për të përcaktuar hapat e mëtejshëm drejt zbatimit të tij.

Një ekspert nga Zyra Federale Zvicerane e Statistikave do të punojë së bashku me INSTAT-in për të përcaktuar hapat e radhës drejt një plani të hollësishëm zbatimi për Regjistrin Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave.



Përmirësimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit dhe infrastrukturave të tjera në Zyrat Rajonale të INSTAT-it

Infrastruktura në Zyrat Rajonale të INSTAT-it është përmirësuar. Infrastruktura e re do të mbështesë punën për koordinimin e zyrave statistikore rajonale, qarqeve dhe bashkive, me qëllim forcimin e sistemit shqiptar të mbledhjes së të dhënave. Mbështetja për projektin përfshinte infrastrukturën e TI-së dhe infrastrukturat e tjera.

Infrastruktura dhe pajisjet e TI-së për Zyrat Statistikore Rajonale përfshinin kompjuterë me UPS, printera, kamera, pajisje konferencash, dhe një sistem për video-konferenca me programin kompjuterik përkatës.

Krahas kësaj, përfshinte edhe programin TEAMS për të përmirësuar komunikimin midis zyrës qendrore dhe Zyrave Rajonale të INSTAT-it për dy vjet, deri në gusht 2022.

Gjatë periudhës prill - korrik 2021, INSTAT-i dhe SALSTAT-i përfunduan lidhjen e rrjetit të zyrës rajonale me rrjetin e brendshëm të INSTAT-it (intranet).

Këtu përfshihej instalimi dhe konfigurimi i programeve të sigurta të klientit në të gjitha zyrat statistikore rajonale, lidhja me rrjetin e INSTAT-it, dhe konfigurimi i pajisjeve ekzistuese në mjediset e INSTAT-it për ta mundur këtë lidhje. Zgjidhja e ofruar përshtatet më mirë me pajisjet në dispozicion të INSTAT-it dhe do të menaxhohet nga Sektori i Administrimit të Rrjetit dhe Serverit.

Tanimë, zyrat rajonale kanë akses të sigurt në sistemet e brendshme të dokumentacionit. Aksesit në intranet përmirëson rrjedhën e punës midis të gjitha zyrave statistikore rajonale dhe zyrës qendrore të INSTAT-it, dhe përbën një hap të rëndësishëm në procesin e digjitalizimit të INSTAT-it.

Veç kësaj, janë zëvendësuar edhe infrastrukturën e tjera përveç TI-së.

Më 17 gusht, Ambasada Zvicerane dhe INSTAT-i zhvilluan një vizitë në terren në Zyrat Rajonale të Korçës dhe Pogradecit. Nga Ambasada Zvicerane morën pjesë znj. Chantal Nicod, Drejtuese për Qeverisjen dhe Shëndetësinë, dhe znj. Elda Bagaviki, Oficere Kombëtare e Programit, ndërsa INSTAT-i u përfaqësua nga znj. Elsa Dhuli, Drejtore e Përgjithshme e INSTAT-it, si dhe drejtore të tjerë të INSTAT-it. Vizita u realizua për të parë nga afër mjediset e punës dhe kontributin zviceran, si dhe për të kuptuar më mirë ndikimin e kontributit zviceran në punën e përditshme të Zyrave Statistikore Rajonale.



Trajnime shitesë për bashkitë

Për shkak të pandemisë, trajnimet e programuara për bashkitë duhet të planifikoheshin dhe të përgatiteshin në mënyrë të hollësishme. Gjatë periudhës 21 qershor - 8 korrik 2021, SALSTAT/ INSTAT-i arritën të organizonin trajnime për "Analizën e të Dhënave Statistikore" me stafin e bashkisë, që bashkëpunon me INSTAT-in për prodhimin dhe mbledhjen e informacioneve statistikore.

Audienca e synuar kryesore për trajnimet përbëhej nga punonjësit që kishin ndjekur trajnimet e mëparshme të organizuara nga SALSTAT/INSTAT-i:

- "Njohuri Bazë rreth Statistikave Zyrtare" nga data 21 shtator deri më 9 tetor 2020, dhe
- "Trajnim i Avancuar për Microsoft Excel" nga data 16 deri më 31 mars 2021.

Krahas kësaj, në këto trajnime u ftuan dhe morën pjesë koordinatorët rajonalë të projektit "Bashki të Forta" (Helvetas) për të përmirësuar sinergjinë ndërmjet dy komponentëve të projektit.

Trajnimet dyditore për grup u organizuan në mjediset e INSTAT-it, në përputhje me masat e vendosura nga qeveria kundër COVID-19.

- Statistika ekonomike
- Statistika mjedisore
- Statistika sociale
- Statistika bujqësore
- Statistika makroekonomike
- Statistika të sektorit real

Trajnimet synonin t'i ofronin stafit të bashkive informacionet e nevojshme rreth statistikave, me qëllim përmirësimin e cilësisë së të dhënave nga bashkitë dhe thellimin e njohurive statistikore.

Në trajnime morën pjesë 90 punonjës të bashkive, nga të cilët 62 (69%) ishin gra.

Pjesëmarrëse të trajnimeve ishin 51 bashki nga 61 në total, që përkthehet në 84% të bashkive.



FALEMINDERIT NGA EKIPI SALSTAT

Menaxher projekti:

Martin Teichgraeber, Zyra Federale Zvicerane e Statistikave

Koordinatorë:

Eralda Pushaj, Koordinatorë me Njësitë e Qeverisjes Qendrore

Edlira Çeliku, Koordinatorë Administrative dhe Financiare

Alketa Doçi, Koordinatorë për Regjistrat dhe të Dhënat Administrative

Instituti i Statistikave - Tiranë

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

Email: info@instat.gov.al

Telefon: +355 (4) 2233356 / 2233358